




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.87/2023

Datë: 08.09.2023

Në bazë të nenit 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27, 34, 35, 39 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012. Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant. Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 26.07.2023, me Nr. Prot. 344/23-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e kapitalit aksionar të Brown-Forman Netherlands (shitës) CC Beverages Holdings II.B.V (blerës) dhe Brown-Forman Finland Oy (targeti). Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 08.09.2023, mori këtë vendim;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqëndrimi i ndërmarrjeve Brown-Forman Netherlands B.V., (shitës) CC Beverages Holdings II B.V., (blerës) lidhur me blerjen e kapitalit aksionar mbi Brown-Forman Finland Oy (targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqëndrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja tre mijë Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 26.07.2023, me Nr. Prot. 314/23-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e kapitalit aksionar mbi Brown-Forman Finland Oy ("Finlandia") nga CC Beverages Holding, kompani private me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Holandës dhe një filial i Coca-Cola Hellenic Bottling Company AG CCHBC". Transaksioni konsiston në blerjen e gjithë kapitalit aksionar të Finlandia nga CC Bevergas Holdings II. B.C.

Palët në Përqendrim:

BROWN-FORMAN NETHERLANDS B.V., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të shtetit të Holandës, me seli në Amsterdam, dhe adresë në Keizersgracht 683, 1017 DW Amsterdam, Holandë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Dhomës së Tregtisë me numër 34313023 (shitësi).

CC BEVERAGES HOLDINGS II B.V., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të shtetit të Holandës, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Dhomës së Tregtisë me numër 33298456 me seli në Radarweg 60, 1043 NT, Amsterdam, Holandë (blerësi).

CCHBC, është aktive përmes filialit të saj në Kosovë **Coca-Cola Hellenic Bottling Kosovo L.L.C**, në të cilën zotëron 100% të aksioneve, me numër unik identifikues 810482216 dhe përfaqësues të autorizuar Nikola Tripkovic, adresë të selisë në Laplje Selo, Kilometri i Pestë, Rr. Prishtinë – Shkup. Aktivitetet e biznesit janë; Prodhimi i pijeve freskuese, prodhimi i ujit mineral dhe natyral.

Brown-Forman Finland OY, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjit të shtetit të Finlandës më datë 20 Nëntor 2013, me numër biznesi ID 25841674 dhe adresë të selisë në Porkkalankatu 24, 00180 Helsinki, Finlandë, e zotëruar 100% nga shoqëria Brown-Forman Netherlands B.V, si palë e synuar pra kompania (target) "Finlandia", që do të blihet nga Beverges Holdings II B.V siç përcaktohet në Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve datë 19 Qershor 2023.

Baza Ligjore

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë më 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i njëres palë në Përqendrim (tregun e brendshëm e kalon shumë më 1,000,000 Euro.
- c) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 19.06.2023.
- d) Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se, Aplikuesi (blerësi) është pronarë 100% i aksioneve të filiale të regjistruar në Kosovë Coca-Cola Hellenic Bottling Company Kosovo L.L.C.

Procedurat e ndjekura:

- a. Vlerësimi i Lëndës
- b. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 14.08.2023

c. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 15.08.2023

d. Më datë 19.06.2023 palët kanë nënshkruar marrëveshjen e shitblerjes së kapitalit aksionar të **Brown-Forman Finland Oy** ("Finlandia") nga **CC Beverages Holdings II B.V.**

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar nuk do të shkaktojë efekte negative në konkurrencës në tregun kosovar dhe as tek konsumatorët në Republikën e Kosovës, dhe si i tillë nuk do të rezultojë me ndryshime në treg për arsye se, shitësi nuk ka filiale në Republikën e Kosovës, mirëpo përmes targetit të saj (Finlandia) shet markat Finlandia Vodka dhe Finlandia Flavored Vodka në Kosovë përmes distributorit G3 Sprits, (një sasi e papërfillshme). Ndërsa pjesa e tregut të Finlandias në tregun e prodhimit dhe shpërndarjes së vodkës është më pakë se 1% në Kosovë në 2022. Blerësi ka një filiale të regjistruar në Kosovë dhe realizon të hyra përmes shitjes së pijeve të ndryshme.

Tregjet e prekura

Në tregun e Kosovës transaksioni nuk rezulton në ndonjë mbivendosje horizontale ndërmjet palëve në tregun e ngushtë të prodhimit dhe shpërndarjes së vodkës.

Aktivitetet e palëve kanë mbivendose vetëm në një treg të gjerë përkatës për prodhimin dhe shpërndarjen e pijeve alkoolike Premium në Kosovë. Në këtë treg pjesa e kombinuar e palëve në vitin 2022 është më pakë se 1%.

Duke pasur parasysh pozitën minimale të etnitetit të kombinuar në tregun e prodhimit dhe shpërndarjes së pijeve alkoolike Premium në Kosovë, transaksioni nuk ka ndonjë shqetësim për konkurrencën, dhe si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës pra nuk do të kufizoj apo të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, meqenëse shitblerja e aksioneve, do të bëhet jashtë Kosovës, palët nuk kanë ndonjë plan tani për investime apo kërkime në Kosovë në lidhje me tregun e prodhimit dhe shpërndarjes së pijeve alkoolike (vodkës), tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregjet Relevante dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu relevant, struktura e tregut do të mbetet e pandryshuar edhe pas transaksionit.

Tregu i Produktit, tregu për prodhimin dhe shpërndarjen e Vodkës.

Tregu gjeografik, do të përcaktohet tregu i hapur.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët, blerësi është pronar i 100% të aksioneve të Coca-Cola Hellenic Bottling Company Kosovë, ndërsa ka bërë një

numër të vogël shitjesh të produkteve të cilat i prodhon përmes distributorit të tij të autorizuar. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës. Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva